

VENDIM
Nr. 82, datë 4.5.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“POWERCOMM” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.5.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Mbikëqyrjes dhe Autorizimeve, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “PowerComm” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 662, datë 24.4.2020, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “PowerComm” sh.p.k., me aplikimin për pajisjen me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, rezulton si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim: neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c” – plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e” – plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal: neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” – plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike: neni 9, pika 4.8, pikat “a”, “b”, “c” – plotësuar.
- Për dokumentacionin e munguar, si kërkesë e nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” do të njoftohet aplikuesi për plotësimin e tij, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “PowerComm” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti